



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.4.2022, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Petro Koçi – nënkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 30 mars 2022.
2. Diskutimi i projektligjit “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzoneve të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”(komision për dhënie mendimi).

Marrin pjesë:

Petro Koçi, Besion Ajazi, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Lindita Buxheli, Ilir Topi, Florenc Spaho, Dasantila Tahiraj, Enslemvera Zake, Meri Markiçi, Luçiano Boçi, Ina Zhupa, Andia Ulliri, Merita Bakiu, Kastriot Piroli, Fadil Nasufi (*zëvendësues*), Ismet Beqiraj (*zëvendësues*), Lavderim Krashi (*zëvendësues*).

Mungojnë:

Flutura Açka, Agron Gjekmarkaj, Blerina Gjylameti, Eralda Bano.

Të ftuar:

Elva Margariti – Ministre e Kulturës,

Entela Çipa - sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Kulturës,

Alban Shanaj - avokat i Studios Ligjore “Tashko Pustina”.

HAPET MBLEDHJA

Petro Koçi - Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në respekt të kalendarit të miratuar më parë, e martë 26 prill 2022, ora 11:41. Pika e parë e rendit të ditës është miratimi i procesverbalit të datës 30 mars 2022. Pika e dytë, diskutimi i projektligjit “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”. Ne jemi komision për dhënie mendimi.

Së pari, do të votojmë për procesverbalin e datës 30 mars 2022? Kush është dakord? Faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka?

Miratohet.

Atëherë, kalojmë te pika kryesore e rendit të ditës, që është projektligji, të cilin sapo lexova. Për këtë projektligj të ftuar nga qeveria janë, zonja Elva Margariti, Ministre e Kulturës. Mirë se erdhët, zonja Ministre!

Zonja Entela Çipa, sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Kulturës. Mirë se erdhët zonja Çipa! Dhe zoti Alban Shanaj, avokat i studios ligjore “Tashko Pustina”. Mirë se erdhët, zoti avokat!

Siç është rregulli i funksionimit të këtyre mbledhjeve, kur shqyrtohen projektligje, së pari i jepet fjala propozuesit, pastaj flasin relatorët dhe më pas bëhet pyetjen dhe diskutime.

Për procedurë e ka kërkuar fjalën zonja Zhupa.

Ina Zhupa - Faleminderit, drejtues i mbledhjes!

Atëherë, ky komision dhe ky Parlament funksionon në bazë të Rregullores dhe pavarësisht numrave që mund të këtë maxhoranca, cilado qoftë ajo, Rregullorja është mbi numrat dhe ajo na bën të bashkëjetojmë në këtë komision, por edhe në Parlament. Para se të citoj Rregulloren, dua të them se është e turpshme që sot duan të kalojnë Butrintin, të japim trashëgiminë tonë kulturore me koncesion, me një marrëveshje sekrete. Si mund të kalojmë me marrëveshje sekrete, dhënien e trashëgimisë kulturore pasurisë kombëtare? Si mund të kalojmë pasurinë kombëtare me kontratë sekrete? Ka dy momente kur bëhen kontratat sekrete, kur është sekret shtetëror me të dhëna që na

i marrin inteligjencat e huaja, SHISH-i dhe të tjera, dhe kur është sekret tregtar. Kjo është pika e parë.

Në bazë të nenit 19 të Rregullores së Kuvendit, përcaktohet detyra e komisioneve e përhershme dhe nënkomisioneve të Kuvendit, pika 1: “Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit mbulon arsimin në çdo nivel, kulturën, rininë, shkencën, sportet, mediat e shkuara dhe vizive”. Butrinti nuk është çështje tregtare. Butrinti nuk është mall. Butrinti është kultura. Në qoftë se nuk e dini, ky komision duhet të ishte, duhet të jetë dhe do të jetë komision përgjegjës për këtë çështje. Shërbimet juridike të Kuvendit na kanë vënë në dispozicion një memo, ku thuhet se në aspektin procedural Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e komisionit përgjegjës, bazuar në nenet 32, 38 të Rregullores së Kuvendit. Memoja është bërë nga këshilltari ligjor Gazmend Bici. Të gjitha këto janë fakte.

Pra, ky komision ka qenë gjithmonë përgjegjës për Butrintin. Ky komision ka organizuar vizita në Butrint, kur bëhej fjalë që Mirela Kumbaro do t’i bënte qofteritë në Butrint, tani qofteritë do ia japim privatit t’i bëjë, që të hiqni të gjithë përgjegjësinë nga vetja. Tani, kjo është në aspektin procedural.

Për sa i përket kalendarit, është vendosur që Komisioni për Ekonominë qenka përgjegjës i kulturës, pra qenka mall Butrinti, qenka një kontratë tregtare dhe po e japim Butrintit një privati në mënyrë sekrete. Butrintin që prodhon 1,5 milionë dollarë nga biletat, pasurinë tonë, do t’ia japim dikujt dhe nuk e dimë se kujt.

Unë kërkoj që mbledhja të shtyhet, sepse është shkelur Rregullorja. Memoja, përcakton se ky komision është përgjegjës, por edhe personalisht do t’i drejtohem zonjës Lindita Nikolla që sot, në mënyrë të tillë, që të ketë mundësi të ndryshojë gabimin, lapsusin që është bërë me qëllim apo pa qëllim, dyshoj me qëllim, për arsye se është marrëveshje sekrete dhe mund ta ketë vetëm kryetari i komisionit përgjegjës.

Duke qenë se në Komision e Ekonomisë është Shalsi kryetar dhe këtu kryetare është Flutura Aça, i bie që ta merrte opozita marrëveshjen. Obobo, ta marrë opozita, marrëveshjen sekrete me të cilën do të jepet pasuria kombëtare, tmerr! Kështu që, unë do t’i drejtohem zonjës Nikolla, duke qenë se Rregullorja e parashikon kështu, memoja e Shërbimit Juridik të Kuvendit e parashikon kështu, edhe tradita e këtij komisioni e parashikon kështu. Në traditën e këtij komisioni është që ka shqyrtuar edhe herë të tjera çështje të Butrintit. Deputetët që janë për herë të parë dhe nuk kanë qenë këtu kur janë shqyrtuar çështje të Butrintit, mund të shikojnë procesverbalet, mund

të pyesin stafin, por kanë shkuar edhe në Butrint për vizitë. Pra, ky është komision përgjegjës, se është çështje kulturore. Në qoftë se do të thoni që Butrinti është çështje tregtare dhe mall, çojeni te Komisioni i Ekonomisë, por në qoftë se Butrinti është trashëgimia jonë kulturore, atëherë është për këtu, ku është kultura. Kjo është shumë e thjeshtë.

Ne nuk e zgjidhim me vota këtë gjë, se kjo nuk është çështje për votim, kjo është çështje Rregulloreje, memoje. Këtu duhet marrë vendim dhe zonja Nikolla do ta shqyrtojë me këshilltarët, punë e saj se si do ta marrë vendimin, sipas Rregullores, por ju këtu me vota, nuk mund të vendosni të shkelni Rregulloren, sepse Rregullorja është mbi të gjithë ne. Prandaj, kërkoj që kjo aferë të shtyhet dhe të kthehemi në komision përgjegjës.

Së dyti, për procedurë kërkoj që, mbasi të kthehemi në komision përgjegjës, siç e detyron Rregullorja, ta shqyrtojmë. Edhe një komision tjetër që ka qenë për dhënie mendimi, Komisioni i Ligjeve, nuk e ka kaluar me konsensus, sepse nuk e kanë pasur marrëveshjen. Mund t'i referoheni për këtë, sepse deputetë, asnjëri nga ju këtu nuk është vegël. Ju jeni të gjithë profesionistë të nderuar, jeni pedagogë, mjekë, profesorë të nderuar, gazetarë të nderuar.

Petro Koçi - Sapo cenuat integritetin, dhe kjo nuk është për procedurë

Ina Zhupa - Ju lutem, ruani integritetin tuaj! Mos u bëni vegla, që të kaloni marrëveshje, që s'i keni parë me sy.

Petro Koçi – Mirë, se kjo nuk është për procedurë.

Ina Zhupa - Për procedurë është.

Petro Koçi – Jo, nuk është për procedurë.

Ina Zhupa - Pika e dytë e procedurës.

Petro Koçi - Integriteti s'ka lidhje me procedurën, është etiketim.

Ina Zhupa – Po, procedurë është. Kam besim te kolegët. Janë njerëz të nderur, nuk do të bëhen vegla.

Petro Koçi - Nuk është për procedurë.

Ina Zhupa - Është për procedurë.

Së dyti...

Petro Koçi - E the, pra, të dytën!

Ina Zhupa - Të lutem, ta mbaroj procedurën, se kemi kohë, s'është me limit koha. Të ngeli gishti te mikrofoni, hiqe gishtin, procedura s'ka limit.

Petro Koçi - Na ke ndërprerë mbledhjen.

Ina Zhupa – Jo, nuk e kam ndërprerë.

Nuk mund të fillojë një mbledhje që është jashtë Rregullores.

Petro Koçi - Po mirë, atë s'e di ti.

Ina Zhupa - Sepse e thotë Rregullorja, zotëri. E thotë Rregullorja, është çështje e kulturës. Butrinti nuk është mall.

Petro Koçi - Vazhdo, por sa më shkurt.

Ina Zhupa - Butrinti nuk është mall, që ju do t'ia jepni një privati.

Petro Koçi – Për procedurë në Parlament koha është 2 minuta, kurse ti po na mban 10 minuta.

Ina Zhupa - Nuk jemi në seancë plenare, jemi në komision.

Atëherë, pika tjetër. Kur ne të kalojmë komision përgjegjës, unë kërkoj që përpara se të thërrasim ministren këtu, atë ministre që kaloi me një copë letër Teatrin Kombëtar, mbasi ishte shembur...

Petro Koçi – Edhe një herë, ka mundësi të ruash etikën kur flet?

Ina Zhupa - ...të thërrasim në këtë komision ekspertët: Neritan Cekën, Agron Alibalin, Kreshnik Merxhanin, Auron Taren dhe kë ekspert tjetër të doni ju, që mund të keni ju, ekspertë shqiptarë, që të flasin për Butrintin, të flasin për nevojën që mund të ketë Butrinti për një menaxhim të ndryshëm nga ky që ka ardhur sot. Pra, të flasin ekspertët dhe pastaj të flasë ministria. Unë kam 200 vërejtje mbi këtë projekt marrëveshje që na ka ardhur sot.

E fundit, si mund të vijë këtu juristi i një firme private “Pustina”, kur ne s'kemi as marrëveshje? Për çfarë mund ta pyesim ne atë, kur s'kemi parë marrëveshjen? Vjen juristi i një firme private për të na sqaruar për një gjë që ne as nuk e kemi parë?!

Si mund të vijë?

Petro Koçi – Të dëgjuam tani.

Ina Zhupa - Zoti Petro, mos përfitoni që ndodheni në atë karrige përkohësisht.

Petro Koçi – Jo tani, se ke tre orë që po na mban fjalim këtu.

Ina Zhupa – S'kam mbaruar.

Petro Koçi – Mirë, mbaruat për procedurë, tani do të vijojmë mbledhjen.

Ina Zhupa – Jo, do të vazhdoj për procedurë dhe kërkoj zbatimin...

Petro Koçi – Do të vijojmë mbledhjen, sepse...

Ina Zhupa – Jo, ne nuk e vijojmë mbledhjen, do të vazhdojmë si komision...

Petro Koçi – Po s’ë vendos ti atë!

Ina Zhupa - Unë do i drejtohem zonjës...

Petro Koçi – Drejtoju kujt të duash, edhe OKB-së.

Ina Zhupa - Zoti Petro, ju nuk mund të vazhdoni mbledhjen.

Petro Koçi – Atë e di unë, s’ë di ti.

Ina Zhupa - Ju duhet të kërkonit një mendim për Rregulloren. Jemi komision për çështje të kulturës.

Petro Koçi – Zonja Ministre, fjala për ju.

Ina Zhupa - Absolutisht, ajo nuk flet.

(Ka zhurmë në sallë dhe deputetja Ina Zhupa vazhdon të flasë pa mikrofon.)

Elva Margariti - Përshëndetje!

Pas një prezantimi dhe një patosi gati kinematografik...

(Deputetja Ina Zhupa ndërhyt pa mikrofon.)

Butrinti nuk është imi personal, edhe as juaji, kështu që sot jemi këtu për të diskutuar këtë projektligj, për të qartësuar çdo element, që deri më sot është ende në të gjitha elementet e padijes. Jemi këtu patjetër për të informuar, për të shtuar elementet e dijes aty ku padija mbizotëron. Jemi këtu për të diskutuar miratimin e “Marrëveshjes për administrimin e nënzoneve të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”.

(Ka zhurmë në sallë dhe debate pa mikrofon.)

Petro Koçi – Garda, ruani rendin!

Elva Margariti - Kjo është një marrëveshje që është miratuar sipas kuadrit ligjor.

(Ka zhurmë në sallë dhe debate pa mikrofon.)

Ina Zhupa - Nuk kalohet Butrinti kështu.

Petro Koçi – A ka mundësi të përmbash veten?

(Deputetja Ina Zhupa ndërhyt pa mikrofon.)

Nuk je ti komandantja e Rregullores.

Zonja Ministre, vazhdoni.

Elva Margariti - Një marrëveshje që ka kaluar sipas të gjithë kuadrit ligjor dhe këtu jemi për të diskutuar.

(Deputetja Ina Zhupa ndërhyt pa mikrofon.)

Ju falënderoj për vizitën tuaj në Butrint një herë, pikë së pari, për shkak se ju është dashur të rikujtoni, që ju keni edhe një Butrint.

Ina Zhupa - Nuk vazhdon...

(Ka zhurmë në sallë dhe debate pa mikrofon.)

Elva Margariti - Të pëlqen, nuk të pëlqen, do ta dëgjosh deri në fund.

Petro Koçi – Me qetësi, zonja Ministre.

Elva Margariti - Nëse ke kritika për të bërë, do t'i bësh në fund. E dëgjuam procedurën tënde, tani do të flas unë.

Petro Koçi – Ju lutem, punonjësve të Gardës, mos lejoni veprime të dhunshme.

(Deputetja Ina Zhupa ndërhyr pa mikrofon.)

Elva Margariti – Është një marrëveshje që është nënshkruar sipas kuadrit ligjor

(Deputetja Ina Zhupa vazhdon të ndërhyjë pa mikrofon.)

Është nënshkruar në muajin nëntor të vitit 2021.

(Deputetja Ina Zhupa vazhdon të ndërhyjë pa mikrofon.)

Ngritja e një fondacioni të posaçëm, që vjen jo vetëm si një kërkesë e kohës, por vjen mbi të gjitha si një detyrim ligjor, është një marrëveshje që do të marrë jetë.

Ina Zhupa - Është një marrëveshje turpi. Është marrëveshja jote e turpit.

Elva Margariti – Turpin ti e vesh për ditë. Ti je fytyra e turpit në këtë komision. Je antinjeriu dhe antifemra.

Ina Zhupa – Turp! Të të vijë zor nga vetja, që ulesh aty.

Elva Margariti – Po flasim këtu për një model menaxhimi dhe sot po flasim sesi pasuritë kulturore administrohen dhe menaxhohen, sepse kultura nuk është një aset, i cili vetëm ka nevojë për buxhete, por kultura është një aset që nëse mirëadministrohet, sjell buxhete në arkën e shtetit.

Marrëveshja që do të marrë jetë me miratimin e këtij projektligji, krijon një model menaxhimi hibrid, ku shteti ka një rol primar.

(Deputetja Ina Zhupa vazhdon të ndërhyjë pa mikrofon)

Më lejoni të sqaroj, shteti ka një rol primar në këtë marrëveshje. Pronësia e territorit dhe asetet e Butrintit i mbeten ministrisë si përfaqësues i shtetit. Mbi bazën e kësaj marrëveshjeje dhe të ligjit, Butrinti i mbetet shtetit dhe do të menaxhohet nga një fondacion i posaçëm, fondacioni i përgjigjet ligjeve të OJF-së. Ky është një fondacion bashkëthemelues midis Ministrisë së Kulturës dhe Fondit Amerikano-Shqiptar për Zhvillim, sipas ligjit shqiptar të OJF-ve. Ministria e Kulturës

ka dy përfaqësues në bordin drejtues, si organi më i lartë i vendimmarrjes së fondacionit dhe bordi kryesohet nga vetë ministri.

(Deputetja Ina Zhupa vazhdon të ndërhyjë pa mikrofon.)

(Deputetët e opozitës largohen.)

Nuk ka asnjë impakt shtesë në buxhetin e shtetit në krijimin e këtij fondacioni. Ministria e Kulturës do të vendosë 2 milionë dollarë kontribut që ndodhen aktualisht në arkën e Butrinti. ADF-ja do të vendosë 5 milionë dollarë si grant. Jemi në rastin e parë të një granti kaq gjeneros për menaxhimin e aseteve tona të kulturës. Në vazhdimësi, fondacioni i posaçëm do të kontribuojë në arkën e shtetit në fondin e trashëgimisë materiale. Hera e parë edhe kjo, që një sit i trashëgimisë kulturore, fillon dhe kontribuon në këtë arkë të re, e cila tashmë ka marrë jetë me një kuadër ligjor dhe nuk do të ketë më asnjë shpenzim nga buxheti i shtetit për pasurinë botërore të Butrintit. Përfitimet e palës shtet në këtë marrëveshje janë jo vetëm investimet që do të kryhen nga donatori në konservimin dhe restaurimin, por edhe në asete të reja, të cilat do të ndërtohen dhe do t'i mbetet Butrinti. Marrëveshja e administrimit do të sigurojë një menaxhim të integruar të pasurisë kulturore dhe natyrore të nënzonës të trashëgimisë dhe të peizazhit të Parkut Kombëtar të Butrintit, i parë në tërësinë e tij dhe jo vetëm në pjesën e zonës arkeologjike.

Në përputhje me të gjitha standardet ndërkombëtare të UNESCO-s dhe të Ramsar-it, do të ketë lehtësira, fleksibilitete dhe avantazhe në mbledhjen e fondeve në shfrytëzimin e financimeve nga burime të ndryshme dhe rritje të të ardhurave nëpërmjet aktivitetit tregtar, por sidomos nëpërmjet sponsorizimit dhe angazhimit të palëve të treta. Do të jenë të gjitha në përputhje me standardet dhe nevojat bashkëkohore sipas kuadrit ligjor dhe sipas rekomandimeve, siç thashë më lart të UNESCO-s dhe të Ramsar-it.

Po ashtu, do të jetë një zhvillim i qëndrueshëm për të gjithë Parkun Kombëtar të Butrintit dhe do të ketë avantazhe ekonomike për komunitetin, ashtu siç është e mirëpërcaktuar në linjat guidë të planit të menaxhimit të integruar të pasurisë kulturore botërore Butrinti, i cili tashmë ka kaluar në të gjitha fazat e miratimeve, duke filluar nga institucionet e larta ndërkombëtare dhe duke vazhduar deri në miratim me vendim të Këshillit të Ministrave për planin e menaxhimit të integruar.

Marrëveshja ka një afat 10-vjeçar me të drejtë rinovimi. Dua të theksoj këtu që rinovimi nuk është automatik, por 6 muaj përpara përfundimit të afatit, palët duhet të fillojnë përsëri një proces rinegociimi, i cili më pas kalon gjithë procedurën si në fillim, me miratimin në Këshillin e Ministrave dhe më pas në Kuvend. Për këtë negociim midis palëve, shteti shqiptar është asistuar

nga studio “Tashko Pustina” dhe prandaj kemi këtu përfaqësuesin ligjor të kësaj studioje, ashtu sikurse edhe pala tjetër është asistuar me studio të tjera avokatie, kjo në kuadrin e plotë ligjor për asistencën që kërkon shteti në rastin e hartimit të marrëveshjeve të posaçme.

Fondacioni i posaçëm është ai që administron pasurinë kulturore sipas kësaj marrëveshjeje në përputhje me destinacionin e saj dhe garanton që shërbimet ndaj publikut, ashtu si dhe promovimi, mbi të gjitha hulumtimet arkeologjike do të kryhen me krijimin e grupit shkencor të Butrintit. Do të doja të ndalesha shumë pak këtu për të saktësuar, që, bashkë me këtë marrëveshje, kalojmë, gjithashtu, edhe të parën marrëveshje të ministrisë, të fondacionit të posaçëm me Institutin e Arkeologjisë, për krijimin e grupit shkencor të Butrintit, sepse fokusi ynë që në fillim ka qenë hulumtimi, restaurimi dhe konservimi i pasurisë Botërore. Për këtë arsye, ne kemi detajuar me Institutin e Arkeologjisë, si institut i specializuar në territorin shqiptar, një marrëveshje të posaçme, e cila do të kalojë së bashku me marrëveshjen e administrimit dhe do të marrë ratifikimin në parlament.

Fondacioni i posaçëm do të kryejë në vazhdimësi marrëveshje me shumë institucione të fushave të ndryshme, por ne krijuam vëmendjen dhe mundësinë që kjo marrëveshje, që të saktësojë më së miri të gjithë pjesën e veprimtarisë arkeologjike që do të kryhet nëpërmjet fondacionit të posaçëm, të ratifikohet në parlament bashkë me marrëveshjen e administrimit.

Në përputhje me ligjin, marrëveshja e administrimit pasqyron, gjithashtu, qartazi të drejtën e ministrisë për të mbikëqyrur mbarëvajtjen e administrimit dhe të aktiviteteve që do të kryhen nga fondacioni për menaxhimin e Butrintit. E theksoj edhe një herë, roli i shtetit është primar. Është gjithmonë shteti ai që ka në pronësi asetet dhe që kontrollon të gjithë mbarëvajtjen e aseteve, në përputhje me nenin 12 të ligjit “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” dhe në përputhje me udhëzimin “Për rregullat e monitorimit të subjekteve që kanë në administrim pasuri kulturore”, në marrëveshje janë parashikuar rregullat për vlerësimin dhe monitorimin e pasurisë nga ana e ministrisë në cilësinë e pronarit shtet.

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes së administrimit, do të kryejë çdo qershor një raportim vjetor te njësia e monitorimit, e ngritur në ministri, lidhur me shërbimet që ofrohen, numrin e vizitorëve, gjendjen e pasurisë, të ardhurat vjetore, ecurinë e planit të biznesit të miratuar, si dhe realizimin e objektivave të parashikuara, si në planin e biznesit, ashtu edhe në planin e menaxhimit të integruar.

Ministria do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm në miradministrimin e pasurisë, duke e mbështetur fondacionin në ushtrimin e funksioneve të ruajtjes, të mbrojtjes dhe duke shërbyer si garante e ruajtjes së vlerave kulturore të sitit, duke garantuar bashkëpunimin maksimal me autoritetet kompetente në kuadër të marrjes së licencave dhe lejeve me autoritetet kompetente ligjzbatuese, duke marrë masat e nevojshme me synim menaxhimin e çdo rreziku të identifikuar në planin e menaxhimit, si dhe duke kryer çdo detyrë ose funksion të parashikuar në ligjin “Për trashëgiminë kulturore”.

Pse një plan menaxhimi i integruar? Shumëkush nga ju mund të pyesë pse nevojitet një formë e re menaxhimi për Parkun Kombëtar të Butrintit, përmes një fondacioni ngritur midis ministrisë dhe një partneri strategjik? Nevoja për një plan menaxhimi të integruar na është paraqitur në mënyrë të vazhdueshme nga institucionet ndërkombëtare për menaxhimin e siteve të trashëgimisë kulturore, por është edhe një nevojë imediate që kemi në të gjithë Shqipërinë, në një epokë të re, kur turizmi kulturor dhe natyror po kthehen në një produkt të shitshëm, por që përballet me kërkesa, të cilat kuadri i ri ligjor i ligjit të trashëgimisë i mirëpërcakton.

Ndaj, në këto kushte, ndërmorën një sfidë (mund të kishim filluar fare mirë me hartimin e planeve të menaxhimit ose të modeleve të reja të menaxhimit në një sit shumë më të vogël dhe më pak ambicioz) me Parkun Kombëtar të Butrintit, që mbrohet nga UNESCO, sepse nëpërmjet këtij modeli synojmë që më pas të kemi mundësinë e replikimit, duke kaluar pikë së pari në modelin më të vështirë me sa më shumë institucione të përfshira dhe për të pasur më vonë eksperiencën dhe të gjithë dijen për ta përshtatur atë edhe në site të tjera.

Duke folur për Butrintin, që është një nga sitet me numrin më të madh të vizitorëve në vend, ai paraqet edhe nevojën më imediate të formave të reja të menaxhimit, sepse potenciali për të ardhurat nga kjo pasuri kulturore është më i larti në vend. Por, patjetër, siç e theksova, ne do të donim që ky të ishte modeli i qëndrueshëm dhe i replikueshëm në sitet e tjera.

Sipas planit të ri të menaxhimit, Parku Kombëtar i Butrintit do të kthehet në një qendër me një shumësi rrathësh koncentrikë, ku nuk kemi vetëm aspektin primar, që është konservimi i trashëgimisë kulturore, por është i lidhur ngushtësisht me të gjithë zonën përreth.

Nuk duhet të harrojmë se Parku Kombëtar i Butrintit nuk është vetëm një park arkeologjik, por është një park me zonën e mbrojtur. Parku Kombëtar i Butrintit është gati 9000 hektarë dhe ne përpara UNESCO-s përgjigjemi për tërësinë e këtij parku dhe jo vetëm për zonën arkeologjike.

Planet e përgatitura në të kaluarën nga viti 2000 deri në vitin 2015, ai 2000-2005, plani i menaxhimit 2007-2012 dhe plani i menaxhimit kombëtar i vitit 2009, nuk kanë pasur në fokus të gjithë pasurinë botërore, por janë përgjigjur ngushtësisht për 614 hektarët e zonës arkeologjike.

Është hera e parë që qeveria shqiptare harton një plan menaxhimi të integruar ku, përveç fokusit të zonës arkeologjike, kemi fokusin edhe në zonat e mbrojtura dhe, mbi të gjitha, një nga linjat guidë dhe më të rëndësishme që na parashtrohet nga të gjithë ndërkombëtarët, është përfshirja e komunitetit.

Në terma afatgjatë, ky dokument synon të ofrojë një qasje të re në sitet e trashëgimisë në vend, një mendësi të re, duke adresuar çështjet që lidhen me kufizimet e instrumenteve të menaxhimit që kemi pasur deri tani, duke iu përshtatur vetëm kuadrit ligjor të buxhetit të shtetit, zhvillimit të qëndrueshëm, rritjes së turizmit kulturor, si dhe ngritjes së kapaciteteve në menaxhim dhe në qasjen ndaj komunitetit lokal.

Plani i menaxhimit të integruar të Butrintit, që është gjeneza e kësaj marrëveshjeje administrimi, ka konsideruar edhe planet e mëparshme të menaxhimit dhe është hartuar në referencë të plotë me ligjin për trashëgiminë të vitit 2018, ligjin për zonat e mbrojtura të vitit 2017, raportin nga Shoqata për Ruajtjen e Shpendëve dhe Gjitarëve të Shqipërisë të vitit 2010, strategji të ndryshme zhvillimi të miratuara nga shteti shqiptar dhe sipas rekomandimeve të institucioneve ndërkombëtare. Ky plan është në përputhje me Agjendën për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030 të Kombeve të Bashkuara dhe me rekomandimet dhe vendimet e Komitetit të Trashëgimisë Botërore dhe organeve këshillimore të qendrës së trashëgimisë botërore në UNESCO, në rakordim të plotë me rekomandimet e dhëna prej tyre, në këto 2 vitet e fundit të dialogut të vazhdueshëm me ta.

Do të doja të ndalesha pak në aspektin arkeologjik, sepse, siç e thashë edhe pak më parë, së bashku me marrëveshjen e administrimit është nënshkruar edhe protokollin i bashkëpunimit me Institutin e Arkeologjisë, sipas të cilit fondacioni i ri do të financojë kërkime arkeologjike përmes granteve vjetore. Grantet do të jepen jo vetëm për studime arkeologjike për Institutin Arkeologjisë, por edhe për studime të tjera, ashtu edhe për florën, faunën apo studime ekologjike në territorin e parkut.

Për sa i përket pyetjes se çfarë do të sjellë ky model për konservimin, restaurimin dhe ruajtjen e monumenteve, ne kemi parashikuar një buxhet të nevojshëm vjetor për të gjitha punimet me karakter konservues dhe mirëmbajtës, duke garantuar në këtë mënyrë ruajtjen dhe përmirësimin e gjendjes fizike në terma afatgjatë të rrënojave arkeologjike. Është parashikuar

qartazi në planin e biznesit që të gjitha rrënojat dhe monumentet e Butrintit të restaurohen deri në vitin shtatë të zbatimit të kësaj marrëveshjeje dhe implementimit të modelit të ri të administrimit.

Modeli financiar parashikon gati 3 milionë dollarë për konservim dhe 600 mijë dollarë shtesë për mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrënojave arkeologjike dhe historike. Pra, jemi në një total prej rreth 3,94 milionë dollarë, duke përfshirë edhe kontingjencën prej 10%.

Menaxhimi i vizitorëve është aspekti më i rëndësishëm me të cilin do të fillojmë menjëherë punën që me ratifikimin e kësaj marrëveshjeje, sepse ky destinacion ndërkombëtar duhet të gjejë një ekuilibër midis vetë asetit të trashëgimisë dhe ruajtjes së burimeve arkeologjike, por edhe atyre natyrore, ekologjike dhe të mjedisit. Kjo është sfida e madhe e Butrintit. Ky është potenciali i lart që ka Butrinti dhe ne këtu duhet të fillojmë.

Propozimi ynë për menaxhimin e vizitorëve vjen me parashikimin e ngritjes së një qendre vizitorësh jo në hyrjen aktuale të Butrintit, por e spostuar gati 1,5 kilometra nga pozicioni aktual, për të krijuar të gjitha mundësitë që ky park kombëtar të synojë të kthehet në të vetmin park arkeologjik carbon free ose minimalisht carbon neutral. Kjo do të thotë se ne duam të kemi një sistem ekologjik, autobusë ekologjikë, lidhje nëpërmjet të gjithë sistemit ujqor të liqeneve përreth zonës arkeologjike, asete që nuk janë shfrytëzuar deri më tani.

Deri tani ne e kemi parë zonën arkeologjike si një ishull të veçuar dhe jo të rrethuar nga një park kombëtar. Krijimi i këtyre sinergjive me parkun kombëtar do ta bëjë Butrintin më të vizitueshëm, jo vetëm në bërthamën arkeologjike, siç e quajmë, por në të gjithë shtrirjen e parkut. Kjo do të thotë detyrimisht një shtrirje akoma edhe më e madhe sinergjie me të gjithë komunitetin përreth, që jeton në mesin e një pasurie botërore, por që nuk ka pasur ende qasjen ekonomike të zhvillimit nëpërmjet këtij parku.

Ne kemi marrë disa modele në vlerësim për të arritur në modelin të cilin propozohet si plani i menaxhimit të integruar, ashtu edhe marrëveshja e administrimit dhe plani i biznesit. Këto modele kalojnë nga Mbretëria e Bashkuar në *Stonehenge*, ashtu edhe në zonat arkeologjike të Pompeit në Itali dhe në aspekte të tjera të parqeve kombëtare, që lidhen kryesisht me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Florida dhe në Kaliforni.

Modeli financiar parashikon kryerjen e investimeve kryesore kapitale, që do të financohen nga partneri strategjik, nëpërmjet një granti në vlerën rreth 5 milionë dollarë, siç e thashë edhe në fillim të fjalës dhe nga fondet e papërdorura dhe të mbartura ndër vite nga vetë zona e administrimit të Parkut Kombëtar të Butrintit.

Investimet kryesore do të shtrihen kryesisht në 5 vjetët e para të operimit me ndërtimin e qendrës së vizitorëve, me punimet e konservimit, me hyrjen e re në sit dhe me bajpasin që duam të krijojmë për të gjithë aksesimin e komunitetit, për shtigjet dhe shërbimet e reja muzeale në kalanë veneciane, sot një aset i fjetur, me interpretim të ri dhe bashkëkohor digjital në të gjithë sitin, si dhe me varkat dhe autobusët ekologjikë për të gjithë vizitorët.

Modeli financiar parashikon që fondet e siguruar nga grante, nga donacione apo të ardhura të vjela nga vetë siti të mbulojnë nevojat financiare për realizimin e investimeve kapitale dhe operimin e sitit sipas modelit të ri të menaxhimit.

Sipas formulës së vetë OJF-ve, çdo e ardhur që vjen nga Butrinti ngel në Butrint. Sot jemi në rastin e parë që kemi një donacion të tillë, gjeneroz, për të startuar modelin e ri të menaxhimit. Nuk parashikohet më asnjë fond shtesë nga buxheti i shtetit, përkundrazi, me modelin që po kalojmë, duke filluar nga viti i katërt do të fillojnë të përdoren tërësisht fondet e krijuara nga Parku Kombëtar i Butrintit në fondin Kombëtar të Trashëgimisë. Pra, vetë Parku Kombëtar i Butrintit do të fillojë të financojë simotrat e veta më të vogla në të gjithë territorin, duke kontribuar me donacione, përqindje të cilat janë parashikuar 0,5, 1 dhe 1,5% në 3 vjetët e para të të ardhurave vjetore të fondacionit, që të derdhen në kasën e madhe të kulturës.

Butrinti, për herë të parë, jo vetëm që çdo të ardhur të vetën do të vazhdojë ta mbajë në Butrint, por do të fillojë të kontribuojë për të gjithë territorin shqiptar për projekte, të cilat, në bazë të programeve të miratuara nga qeveria shqiptare për restaurimin, konservimin dhe zhvillimin e pasurive kulturore, do të mund të kenë mundësinë që të gjejnë financimin e tyre nëpërmjet të ardhurave të Butrintit.

Në planin e biznesit kemi parashikuar kontributin në mënyrë specifike për atë çfarë ne mendojmë se Butrinti duhet të hedhë në fondin e trashëgimisë kulturore. Siç e thashë edhe pak më parë, për ne është e rëndësishme të fillojë të flitet, sidomos sot, kur në të gjithë botën aspekti mjedisor dhe ekologjik është kthyer në një emërues të përbashkët të shumë nismave, jo vetëm të qeverisë shqiptare, por në mbarë globin, për një sit pasuri kulturore UNESCO *carbon - free*. Administrimi i ri me një ndërhyrje pozitive ndaj emetimi të dioksidit të karbonit ose të paktën në nivelin neutral është një nga qëllimet madhore të këtij modeli dhe do të ishte i pari në rajon. Patjetër që ambicia jonë është e madhe, që të arrijmë të kemi në Butrint të parin sit arkeologjik *carbon - free* të rajonit.

Gjendja aktuale e krijuar nga rruga e re për në Ksamil deri në vendkalimin e Lundrës në kanalën e Vivarit e ka ndikuar negativisht asetin natyror mjedisor të Butrintit, ka rënduar trafikun, ka shkaktuar jo vetëm ndotje atmosferike, por edhe akustike në hyrje të Butrintit. Patjetër që hyrja aktuale në pozicionin që ka sugjeron zhvendosjen dhe një mirëformim të të gjithë qendrës së vizitorëve, e cila nuk duhet të jetë thjesht një qendër parkimi, siç është aktualisht, por duhet të jetë një qendër e mirëfilltë, me asete të shtuara, për të krijuar edhe mundësinë e të tjera prurjeve ekonomike, dyqane për shitjen e suvenireve ose një qendër e vërtetë muzeale dhe vizitorësh, përveç nyjeve sanitare, përveç tureve virtuale 3D, të cilët duhet të aksesohen dhe duhet të fillojnë të shtohen në të gjithë zonën jo vetëm atë arkeologjike, por edhe atë të zonës natyrore.

Qendra e vizitorëve do të konceptohet përmes një konkursi arkitekturor ndërkombëtar. Është një tjetër mundësi e mirë që na jepet që në këto faza të para për të filluar dhe promovuar Butrintin tonë. Kostot për konkursin e qendrës së vizitorëve, që, sipas parashikimit, shkojnë në rreth 100 mijë dollarë, do të financohen po njësoj në formë granti nga partneri strategjik. Pra, edhe një herë, shteti shqiptar nuk do të avancojë me buxhetin e shtetit për këto hapa.

Të gjitha ndërtimet dhe operacionet e ardhshme në park do të plotësojnë kushtet e një certifikimi të përshtatshëm të ekoturizmit nga Shoqata Ndërkombëtare e Ekoturizmit apo certifikime të tjera të ngjashme. Këto janë parashikuar, si në planin e menaxhimit, ashtu edhe në marrëveshjen e administrimit, sepse do t'i japim përparësi njëkohësisht përdorimit të materialeve lokale, duke e shoqëruar me praktika operationale të qëndrueshme edhe në zhvillimin e komunitetit.

Interesi i komunitetit që jeton brenda dhe përreth parkut ka qenë një nga pikat kyçe të të gjithë diskutimit që kemi bërë në institucionet ndërkombëtare. Do të doja të ndalesha pak këtu, sepse kjo kërkesë e vazhdueshme e institucioneve ndërkombëtare, që në hartimin e planit të menaxhimit të integruar për ne ka pasur kapituj dhe negocime të gjata për të gjetur mundësinë nëpërmjet këtij modeli menaxhimi për të mos ngecur në elementin primar të përgjegjësisë që ka Ministria e Kulturës, të menaxhimit thjesht të bërthamës arkeologjike, por duke e parë në të gjithë rrathët koncentrikë që krijon ky model i menaxhimit të parkut drejt qasjes që ka me komunitetin.

Deri më sot, komuniteti është parë vetëm si një ndërlidhës në momentet kur ne krijojmë një hapësirë të dedikuar në hyrje të Butrintit, për të pasur disa elemente të spostueshme, ku ata mund të shesin produktet e tyre artizanale. Ndërsa në këtë plan menaxhimi dhe në këtë model administrimi, komuniteti shikohet si faktor kyç për të pasur të gjithë ndërveprimin e tyre, për të

çuar më tepër paratë e këtij plani drejt vetë komunitetit. Patjetër që do të jenë të angazhuar në shërbimet e qendrës së vizitorëve, në guidat turistike lokale, si dhe në të gjitha proceset e mirëmbajtjes apo restaurimit të monumenteve.

Modeli i ri synon të punësojë deri në vitin e shtatë 104 banorë lokalë, nga të cilët 44 do të jenë me kohë të plotë. Ata do të jenë pjesë e trajnimeve të herëpashershme nga fondacioni në aspektin sipërmarrës, turistik, mjedisor dhe bujqësor. Të gjitha këto trajnime do të jenë të financuara nga fondacioni për menaxhimin e Butrintit, për të afruar më tej komunitetin me Butrintin.

Mosangazhimi i komunitetit në të gjitha format, në menaxhimin e parkut, ka qenë një pengesë që ka çuar gati në mospunimin e modelit aktual të Butrintit. Prandaj kemi studiuar modele të vendeve të tjera dhe prandaj i kemi kushtuar shumë vëmendje në këtë plan.

Duke forcuar lidhjet ekonomike nëpërmjet punësimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë midis banorëve dhe veprimtarive që lidhen me zonën arkeologjike dhe me pjesën mjedisore, me punimet e mirëmbajtjes, me organizimin e veprimtarive edukuese, interpretuese dhe udhërrëfyese, për të vazhduar me atë që deri diku është kthyer në një traditë të vogël, por duke e fuqizuar edhe më tej me prodhimin artizanal ose paraqitjen e produkteve artizanale, kemi hartuar një plan edhe për të gjithë pjesën e promovimit, etiketimit dhe brendimit të vetë parkut, duke e lidhur këtë edhe me produktet e tjera lokale të zonës që të brendohen në të gjithë botën si produkte të prodhuara në Butrint.

Krijimi i një shumëllojshmërie ofertash turistike duhet të dalë përtej aspektit dhe mendësisë së ngushtë të zonës arkeologjike, duke e lidhur atë më tepër me një potencial të pashfrytëzuar deri tani, që lidhet me turizmin e *hiking ose trekking* në parqet kombëtare. Shumë turistë të huaj preferojnë të spostohen drejt veriut, ndërkohë që Parku Kombëtar i Butrintit paraqet një florë dhe faunë unike, specifike në rajon.

Mbështetja dhe nxitja e bashkëpunimit me artizanët lokalë do të vazhdojë të fuqizohet. Në këtë plan menaxhimi kemi parashikuar rreth 300 mijë dollarë grante për banorët vendas, që jetojnë në zonat përreth Butrintit, të cilat do të jepen për ata banorë që dëshirojnë të investojnë, si në produkte prodhime artizanale apo bujqësore, ashtu edhe në bujtina lokale, me fokus promovimin e prodhimeve vendase.

Është hera e parë që shtyhem në këtë drejtim, sepse deri më tani vetë shteti ose Parku Kombëtar i Butrintit ka krijuar facilitete për prezencën e tyre fizike në territor, por jo mbështetje

në formë grantesh. Prandaj, i kemi dhënë një vlerë të veçantë edhe këtij ndërveprimi me komunitetin, duke gjetur të gjitha mundësitë edhe ekonomike dhe duke i parashtruar që në marrëveshjen e administrimit.

Doja të ndalesha shumë pak në modelet e administrimit që kemi studiuar, sepse kjo ka qenë shtysa fillestare për të parë dhe për të vlerësuar në të gjithë botën se si site të tilla të integruara, jo vetëm arkeologjike, por brenda një parku kombëtar, menaxhohen. Kemi parë modelin *Stonehenge*, për të cilin janë bërë marrëveshje të shumta mbi pronësinë e tokës, por duke përfshirë gjithmonë organizata jofitimprurëse. Në rastin e *Stonehenge* kemi *National Trust*, që është një autoritet kombëtar për ruajtjen e vendeve me interes historik dhe bukuri natyrore. Gjithashtu, kemi studiuar modelin e Versajës, që është një monument historik në pronësi të shtetit francez dhe i mbikëqyrur nga Ministria e Kulturës me të njëjtin model si modeli që ne prezantojmë me administrim dhe menaxhim financiar të pavarur.

Jemi në të njëjtën linjë si në modelin e Versajës, për të vazhduar me qytetin romak të Pompeit, që është në pronësi të shtetit italian, është objekt i një projekti konservimi afatgjatë në mbarë sitin, i mbështetur nga një konsorcium financuesish privatë, universitetesh e shoqërisht, që ofron një program vjetor për shkolla verore dhe teknika konservimi arkeologjik.

Jemi ndalur këtu, ashtu siç thashë, në protokollin e bashkëpunimit, të hartuar midis fondacionit dhe Institutit të Arkeologjisë, dhe tashmë ne krijojmë Butrinti Research Center. Sjellim për herë të parë një tjetër bërthamë të kërkimit shkencor, që financohet nga vetë fondacioni. Modelet italiane të menaxhimit, konkretisht modelet e fondacionit, Muzeu i Antikiteteve Egjiptiane në Torino dhe fondacionit-muze të Torinos, kanë paraqitur shumë ngjashmëri me model që ne prezantojmë. Është i ngjashëm me modelin, sa i përket formës së bashkëpunimit nëpërmjet një fondacioni të posaçëm, të themeluar nga vetë Ministria e Kulturës italiane me organet vendore dhe disa fondacione të tjera private.

Ky fondacion është krijuar në bazë të një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës, rajonit të Piemontes, provincës së Torinos, qytetit të Torinos dhe fondacionit privat *Compagnia di San Paolo*. Patjetër që u jemi përshtatur modeleve ndërkombëtare sipas kuadrit të ri ligjor, që tashmë edhe shteti shqiptar, me ligjin “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” parashikon mënyra të ndryshme të administrimit të pasurive kulturore. Është shumë i ngjashëm me rastin e fondacionit-muze të Torinos, sa i takon formës së administrimit. Patjetër që krijimi i këtyre fondacioneve sjell potencialin e shtimit të sponsorëve, të donatorëve ose të anëtarëve të

tjerë në bord, që fillojnë e krijojnë më tepër qasje jo vetëm në aspektin ekonomik, pra në formën e granteve, duke kontribuar në fondacion, por patjetër edhe me ekspertë të shtuar.

Aktualisht, siç thashë, bordi i Butrintit ka dy përfaqësues nga Ministria e Kulturës, kryesohet nga Ministri i Kulturës, janë dy përfaqësues nga partneri strategjik, ndërsa përfaqësuesi i pestë është një ekspert i jashtëm, i cili zgjidhet në dakordësi midis palëve. Në rastin konkret, jam e nderuar që kemi profesorin Richard Hodges, sepse është një nga njohësit më të mëdhenj të Butrintit në arenën ndërkombëtare të studiuesve, i cili ka pranuar të jetë pjesë e kësaj sfide dhe të bashkohet me modelin e ri të menaxhimit. Patjetër që është edhe një nga ata elementë që e shton akoma më tepër promovimin e Butrintit në gjithë netuorkun ndërkombëtar të ekspertëve të arkeologjisë. Synimi ynë është që sot të fillojmë modelin e ri të menaxhimit nëpërmjet këtij fondacioni me një partner dhe të vazhdojmë të shtojmë radhët e partnerëve, të cilët krijojnë besim në këtë menaxhim dhe bëhen pjesë e sfidës sonë të madhe. Plani që kemi hartuar është një marrëveshje dhjetëvjeçare dhe patjetër që kjo marrëveshje krijon të gjitha mundësitë, që ministria të mbikëqyrë e të ndërmarrë masa të menjëhershme, nëse marrëveshja nuk shkon sipas planit të biznesit, ose të rishikojë dhe të shtojë në çdo moment partnerët e tjerë, aktorët e tjerë, të cilët mund t'i afrohen Butrintit për të qenë pjesë integrale e këtij menaxhimi.

Sot po diskutojmë një nga mendësitë e reja të menaxhimit të siteve-pasuri kulturore, ndaj patjetër që presim shumë polemika, por patjetër edhe shumë ngurtësi nga ata që nuk shohin dot përtej kulturës thjesht si element identitar për t'u ruajtur. Ne jemi sot këtu për të diskutuar atë që në të gjithë botën është bërë vite e vite më parë. Kultura nuk është thjesht një aset që lyp lekë, por kultura është një aset që i jep lekë shtetit. Nuk jep vetëm ushqim për trurin, por jep patjetër ushqim edhe për arkën e shtetit. Kemi mbi dy vjet që e studiojmë këtë në Ministrinë e Kulturës, që hartojmë ligje, që hartojmë të gjitha kuadrot ligjore e nënligjore, që hartojmë plane menaxhimi, që studiojmë modele të ndryshme. Nuk është një punë që ka lindur thjesht gjatë muajve të fundit, për t'u paraqitur pastaj për diskutim në parlament. Vetë marrëveshja e bashkëpunimit midis ministrisë dhe partnerit strategjik dhe krijimi i fondacionit të posaçëm kanë kaluar në plot vendimmarrje në ministri nga më të ndryshmet.

Siç thashë, rasti i Butrintit është një rast unikal, sepse përveç zonave të turizmit, përveç të gjitha planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura, kemi përfshirë Ministrinë e Bujqësisë, me zonën me potencial të madh bujqësor që ka vetë Parku i Butrintit, por po ashtu siç kemi përfshirë edhe Ministrinë e Financave e të Ekonomisë, për të krijuar për herë të parë një model të tillë, ku

shteti ka rolin primar. Sepse shteti nuk është thjesht një dorë që shtrihet për të mbajtur dhe ruajtur pasurinë, por është politikëbërësi për menaxhimin e siteve.

Jam e gatshme t'i përgjigjem çfarëdolloj pyetjeje dhe të ofroj çfarëdolloj informacioni, që ju do të kërkonte në lidhje me këtë sfidë që ka ndërmarrë Ministria e Kulturës.

Faleminderit!

Petro Koçi – Faleminderit, zonja Ministre!

Para se t'ia jap fjalën relatores Tahiraj, dua të theksoj disa gjëra të aspektit procedural. Së pari, nuk është komisioni ai që vendos të ketë kompetencën gjatë shqyrtimit të projektligjit, nëse është komision për dhënie mendimi apo komision përgjegjës. Siç e dimë të gjithë, këtë kompetencë e ka Konferenca e Kryetarëve dhe ne nuk jemi në një moment që mund ta kthejmë mbrapsht gjithë këtë procedurë.

Së dyti, mendoj se nuk cenohet dinjiteti i një komisioni në këtë rast, siç është rasti ynë, që jemi caktuar për dhënie mendimi. Pse e them këtë gjë? Sigurisht, edhe unë mund të kem pikëpyetje e mia. Ne mund të ishim një komision përgjegjës, por nuk besoj se kjo cenon dinjitetin dhe kompetencat e këtij komisioni. Unë besoj se zëri i këtij komisioni në seancë parlamentare do të jetë shumë i rëndësishëm edhe për t'u dëgjuar, edhe për t'u përcaktuar pastaj në votim e gjithë seanca.

Së treti, dua t'i kërkoj falje publikut lidhur me gjestet që ndodhën më parë, pavarësisht se këtu përgjegjësia është gjithmonë personale. Mendoj se modeli i veprimeve të dhunshme dhe i fjalorit që cenon integritetin e kolegëve, është një model i gabuar për publikun. Ne kemi nevojë që ambientet, strukturat parlamentare të jenë model qytetarie. Çdo sjellje antiqytetare vetëm e dëmton publikun dhe sjelljen e tij. Ndërkohë, pa dyshim i bën dëm edhe imazhit të personit apo të personave, që përfshihen në sjellje të tilla. Dhuna nuk është argument. Dhuna është një instrument, që shpeshherë vjen si produkt i emocionalitetit të pakontrolluar, por që cenon edhe të drejtën e çdo pretendimi. Në rastin konkret, pretendimi lidhur me një marrëveshje, duke u shoqëruar me dhunë, praktikisht rrëzohet me argumente, nuk shëndoshet me argumente. Edhe unë bëj pjesë tek ata, të cilët mund të jenë skeptikë për shumë marrëveshje që kanë ndodhur në vend deri tani, por kjo s'do të thotë se duhet të paracaktohem automatikisht kundër marrëveshjeve të tilla.

Kësisoj, do t'ju lutesha të vijojmë mbledhjen në mënyrë normale. Fjalën e ka zonja Tahiraj, si relatore e caktuar për projektligjin në fjalë.

Desantila Tahiraj – Faleminderit, kryetar i seancës!

Siç e dimë, Konferenca e Kryetarëve ka caktuar Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik si komision për dhënie mendimi. Lapsusi që këshilltari kishte bërë në memo, është sqaruar me ne relatorët, që në ditën kur na erdhi e-maili. Gjithsesi, çdonjërit nga ne i ka lindur pyetja se si një aset kulturo kaq i madh, një aset kombëtar si Butrinti, një nga perlat e kulturës shqiptare, nuk është menaxhuar më mirë. Apo jo? Kjo pyetje më ka lindur mua, por i ka lindur edhe shumë vizitorëve të atij parku arkeologjik, e jo vetëm.

Është pikërisht ky projektligj, i cili miraton marrëveshjen për administrimin e nënzoneve të trashëgimisë kulturore e të peizazhit kulturor si pjesë të Parkut Kombëtar të Butrintit, lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për menaxhimin e Butrintit. Sa i përket bazës kushtetuese të këtij projektligji, kjo është nismë e Këshillit të Ministrave, e mbështetur në nenet 78 e 83 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 172, pika 5 të ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

Sa i përket qëllimit dhe përmbajtjes së këtij projektligji, projektligjit “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzoneve të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”, në fakt, kjo marrëveshje është nënshkruar më 16 nëntor të vitit 2021 ndërmjet Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit dhe Ministrisë së Kulturës, e cila ndër të tjera përcakton afatin, tarifat, kushtet e veçanta për administrimin e kësaj pasurie kulturore. Gjithashtu, lidhja e marrëveshjes së administrimit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit ka si qëllim administrimin efektiv sipas një modeli administrimi, i cili synon konservimin, mbrojtjen dhe rritjen e vlerave të trashëgimisë kulturore të nënzonës së kësaj trashëgimie dhe të peizazhit kulturor të Parkut Kombëtar të Butrintit.

Në bazë të kësaj marrëveshjeje, janë përcaktuar fare qartë rregullat për kalimin në administrim të pasurisë kulturore, e cila përfshin të drejtën e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, për përdorimin, shfrytëzimin, promovimin, të drejtën për të përcaktuar e mbledhur tarifat, çmimin e biletave, dhënien në përdorim në të gjitha format, në kuptim të Kodit Civil e të ligjit “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

Marrëveshja lidhet me një afat dhjetëvjeçar, me të drejtë rinovimi, në bazë të negociatave që palët do të zhvillojnë me njëra-tjetrën, në këtë rast, fondacioni dhe Ministria e Kulturës. Forma e administrimit direkt, e adoptuar nga ligji “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” është sipas modelit italian të administrimit, dhe të gjithë jemi koshientë se modeli italian është një nga modelet

më perfekte të administrimit të këtyre pasurive kulturore. Në bazë të këtyre modeleve rezulton se kalimi në administrim bëhet në favor të organizatave jofitimprurëse, të krijuara nga institucione shtetërore ose në bashkëpunim mes këtyre të fundit, të organizatave jofitimprurëse, kryesisht të fondacione.

Nënzona e trashëgimisë kulturore dhe e peizazhit kulturor të Parkut Kombëtar të Butrintit është një pasuri kulturore arkeologjike me rëndësi universale, e cila përfshin në tërësinë e saj një shumëllojshmëri kategorish të pasurive kulturore për zhvillimin e një sërë aktiviteteve kulturore e tregtare.

Marrëveshja përfshin dispozita mbi të drejtat reale, që i kalohen Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, garancitë që ofron ministria në cilësinë e pronarit-shtet, si dhe të drejtat mbi pasuritë e luajtshme, që kalohen së bashku me pasurinë e paluajtshme. Në këtë aspekt, nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit i kalon e drejta e posedimit, përdorimit, shfrytëzimit dhe gëzimit të pasurisë së paluajtshme, por jo pronësia e saj, e cila në çdo rast i mbetet shtetit. Pra, kjo është një pikë shumë e rëndësishme, ku pronësia i mbetet shtetit, dhe shteti vazhdon të monitorojë procesin gjatë gjithë kohës.

Në marrëveshjen objekt shfrytëzimi janë përfshirë parashikime për format dhe kushtet e ruajtjes e të mbrojtjes, format e përdorimit, ruajtja fizike, hyrja e publikut dhe shërbimet ndaj tij, promovimi, hulumtimet arkeologjike, që janë gjithashtu shumë të rëndësishme, parashikimet lidhur me ndërtimin e qendrës së vizitorëve, studimet dhe analizat që do të kryhen, si dhe krijimi i grupit shkencor të Butrintit.

Duke marrë në konsideratë rrethin shumë të gjerë të funksioneve dhe tagrave që i kalohen Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, i cili përfshin pjesën më të madhe të detyrimeve e përgjegjësisve në lidhje me ruajtjen dhe menaxhimin e sitit, pjesëmarrjen e ministrisë dhe menaxhimin e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, përmbushja me efektivitet e funksioneve të caktuara mund të arrihet vetëm nëpërmjet një kohëzgjatjeje minimalisht dhjetëvjeçare.

Cilat janë efektet e pritshme? Efektet e pritshme që synohen të arrihen nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, mbështetur në mënyrën e administrimit nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, kryesisht do të jenë këto:

-Zhvillim i qëndrueshëm për të gjithë Parkun e Butrintit dhe avantazhe ekonomike për komunitetin lokal, nëpërmjet rritjes së fondeve e investimeve, në përmirësimin e infrastrukturës turistike, zhvillimit të kapaciteteve lokale dhe rritjes së punësimit në park.

-Menaxhim i integruar i pasurisë kulturore e natyrore të nënzonës së trashëgimisë dhe gjithashtu peizazhit kulturor të këtij parku fantastik, në përputhje me standardet ndërkombëtare të një qendre, e cila është njëherësh edhe pasuri botërore e UNESCO-s.

-Fleksibilitet dhe avantazhe në mbledhjen e fondeve, ekspertizë e kualifikuar dhe menaxhim, kërkim, konservim, marketing në përputhje me standardet dhe nevojat bashkëkohore. Dua të theksoj faktin e ekspertizës së kualifikuar, sepse është vërtet e nevojshme që ai park, ajo pasuri e madhe, siç e tha edhe ministrja, jo vetëm në kuadrin e pasurisë shqiptare, por në kuadrin e një pasurie botërore të kulturës, ka nevojë për ekspertizë të kualifikuar, strukturë dhe menaxhim të kualifikuar për fushat e nevojshme të ekspertizës e të menaxhimit.

Sa i përket efekteve financiare, në këtë marrëveshje është përcaktuar se fondacionit të posaçëm do t'i transferohet shumë financiare e gjendjes aktuale të llogarisë. Vlera e financimit nëpërmjet grantit do të jetë 4 milionë e 985 mijë dollarë.

Në përfundim, ky projektligj “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzoneve të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit” është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” si dhe ka respektuar kërkesat e Rregullores së Kuvendit për paraqitjen e tij.

Ju faleminderit!

Petro Koçi – Faleminderit, kolegja Tahiraj!

Kanë kërkuar fjalën zoti Ndreca, zoti Spaho dhe zoti Beqiraj.

Ndërkohë, unë dua të bëj vetëm dy pyetje para se t’ua jap fjalën kolegëve.

Së pari, përgjithësisht publiku është skeptik kur asete publike apo shtetërore u jepen për menaxhim fondacioneve apo subjekteve private. Këtë e kam edhe nga një përvojë, që besoj se ndahet nga të gjithë ju, siç është rasti i privatizimeve. Për shembull, kur është privatizuar ARMO në Fier apo Uzina e Ballshit, u ndërpre i gjithë procesi i përpunimit ose i trajtimit të industrisë së naftës, gjë që në fund rezultoi dizastër. Në fund, siç e dimë, dhe zoti Beqiraj e di shumë më mirë, një aset i jashtëzakonshëm siç ishte Uzina e Naftës në Ballsh u shkatërrua, sepse momenti i privatizimit dhe mënyra e privatizimit ishin skandaloze. Po ashtu, ka edhe ngjarje të tjera të këtij lloji.

Tani, në rastin konkret, unë dua të di: cilat janë garancitë se këtu kemi të bëjmë me një marrëveshje që na sjell vetëm shëndetshmëri në trajtimin e një aseti të jashtëzakonshëm të trashëgimisë kulturore, siç është Butrinti?

I kuptoj modelet ndërkombëtare në mënyrë të jashtëzakonshme, por nganjëherë ne dështojmë kur adoptojmë në vend modele që vijnë nga jashtë, të cilat janë vërtetë të suksesshme. Pra, unë besoj se kjo është një pikëpyetje që duhet ta ketë publiku. Ndoshta është edhe një nga shkaqet që, ata të cilët janë paraprakisht opozitarë me marrëveshjen, e shfrytëzojnë për ta njollosur, po themi, ose për ta paranjollosur atë.

Pyetja e dytë ka lidhje me natyrën e marrëveshjes. Duke mos qenë financier dhe ekonomist, unë e konsideroj sekretin tregtar si një nga gjërat më negative që ka bota, sepse ky sekret tregtar nuk është model shqiptar. Në rastin konkret, marrëveshja është konfidenciale, nuk po them sekret, sepse është fjalë e tepërt, por është konfidenciale. Përderisa, siç duket nga marrëveshja, menaxhimin do ta bëjë një fondacion ose fond, një grup menaxhimi i cili nuk ka për qëllim biznesin, fitimin, atëherë përse marrëveshja është konfidenciale?

Këto dy pyetje kisha unë. Pastaj, me radhë: Ndreca, Spaho dhe Beqiraj.

Falemnderit!

Elva Margariti – Atëherë, garancitë e suksesit të këtij modeli janë modelet që kemi studiuar, modele të të gjithë botës. Fakti pse aktualisht Butrinti nuk ka shfrytëzuar maksimalisht potencialin që ka për një zhvillim ekonomik, ka ndodhur ngaqë i është nënshtruar po njësoj disa skemave rigjide të buxhetit të shtetit. Aktualisht, Butrinti arrin që deridiku të dalë jashtë skemave të buxhetit të shtetit vetëm për faktin se paratë e mbledhura nga të ardhurat vjetore të Butrintit vazhdojnë të ngelin në arkën e Butrintit, edhe nëse nuk janë shpenzuar, dhe mbarten në vitet e mëpasshme. Ka një vendimmarrje të gjerë, aktualisht ekziston një bord menaxhimi të Butrintit, ku përfshihen institucione të ndryshme, mes të cilave është edhe Instituti i Arkeologjisë, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Turizmit, por ngërçi real është aspekti i mungesës së zhdërvjelltësisë që kemi, po themi, duke qëndruar brenda kësaj skeme shtetërore dhe në thithjen e fondeve. Thithja e fondeve në një fondacion është aspekti primar. Aktualisht, ne po krijojmë një fondacion, në të cilin partneri strategjik vjen që në fillim me një grant të qenësishëm. Partneri u përgjigjet të gjitha linjave-guidë të planit të menaxhimit të hartuar dhe të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe sipas rekomandimeve të UNESCO-s. Pra, fondacioni na bën të mundur të kemi sponsorë të tjerë, të kemi grante të tjera, të kemi një zhdërvjelltësi të hyrjes së parasë jo

vetëm nga të ardhurat e Butrintit. Sot të ardhurat e Butrintit janë vetëm nga numri i vizitorëve, pa krijuar asnjë lloj aksesit tjetër të thjeshtësuar për thithjen e parave të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk preferojnë të dhurojnë në kasën e madhe të shtetit, dhe nuk është hera e parë që ne përballemi me një problematikë të tillë.

Fondacioni i posaçëm është një fondacion, i cili menaxhon asetin, por nuk e ka në pronësi asetin. Asetin e ka në pronësi shteti, dhe këtu dalim komplet jashtë të gjitha skemave të privatizimit, të koncesioneve e të çfarëdolloj emri me konotacion negativ, që do të donim t'i vendosnim kësaj marrëveshjeje. Ajo krijon mundësinë e lehtësimit të burimeve financiare në sit dhe të zhvillimit të mëtejshëm të sitit, duke parë jo vetëm bërthamën arkeologjike si potencial zhvillimi, pra jo vetëm vizitorin e turizmit kulturor, por edhe zonën mjedisore përreth (sepse ky është potenciali, ky është uniciteti i vërtetë për të cilin edhe UNESCO mbron Butrintin dhe e fut në sitet botërore), sepse në gati 9 mijë hektarët e tij ka larmi zonash dhe potencialesh natyrore, mjedisore, ekologjike, flora, fauna, komuniteti përreth... Të gjitha këto aspekte janë bërë bashkë, janë shtruar nëpërmjet linjave guidë të planit dhe janë përkthyer në linja operacionale ekzekutive, duke përcaktuar afate dhe buxhete.

Do ta rikthejsoja edhe më shumë që ne kemi negociuar gjatë dhe kemi parë modelet dhe hedhjen e parasë në të gjithë planin e detajuar që është bërë për ngritjen e Qendrës, për konservimin dhe restaurimin, ashtu siç kemi parë edhe mundësinë që Butrinti të fillojë të hedhë para në kasën e madhe të trashëgimisë kulturore. Kemi krijuar për herë të parë një fond të kujdesit të trashëgimisë kulturore.

Ministria e Kulturës fillon dhe krijon kapacitetin e saj, ashtu siç bëri Butrinti, që mbarti nga viti në vit kasën e tij, pra këtë ta bëjmë një kastë të madhe. Sakaq, mirëmenaxhimi i Butrintit, që është sot potenciali, aseti më i madh që kemi, do të thotë një mirëmenaxhim i të gjitha aseteve në territor. Prandaj do të doja që kjo të ishte një nga elementet që të mos kalojë pa vëmendje.

Aseti është pronë e shtetit dhe ngel pronë e tij. Fondacioni ka shtetin në krye të këtij menaxhimi. Vetë Ministria e Kulturës është anëtare e këtij fondacioni dhe ky i fundit është një instrument për të thjeshtuar akoma më tepër zhvillimin ekonomik dhe thithjen e të ardhurave.

I gjithë aseti i ngel shtetit, nuk i kalohet në pronësi askujt, as një fondacioni, as një subjekti privat. Thjeshtojmë të gjithë procedurën nëpërmjet ligjit të trashëgimisë, i cili na krijon mundësitë e administrimit të pasurive kulturore, duke u përshtatur edhe me ligjin e OJF-ve.

(Drejtuesi i komisionit ndërhyt pa mikrofon.)

Lidhur me konfidencialitetin, ai qëndron vetëm për të gjitha aspektet ekonomike, të cilat janë të qartësuara në detajet e qindarkës në planin e biznesit.

Plani i biznesit është në vetvete, po themi, një marrëveshje, e cila patjetër që ka kaluar një sërë negociimesh, një sërë rishikimesh dhe vendimmarrjesh nga institucionet shtetërore. Plani i biznesit është për ne një element kyç, i cili ka mundësinë e konfidencialitetit sa kohë aty kemi edhe një marrëveshje në formën e grantit dhe operacionalitetin e tij në territor. Por kjo nuk do të thotë që të gjitha elementet për të cilat do të ketë pikëpyetje... Është një produkt voluminoz tabelar, ai i cili parashtrohet në planin e biznesit, të cilin ne e kemi zbërthyer në narrativë ekonomike, ligjore në të gjithë relacionin që kemi parashtruar.

Vetëm se nuk do të doja të keqinterpretoshin të gjitha elementet e parashikuara në planin e biznesit në këto komisione, për sa kohë, e përsëris, ministria ka të gjithë tagrin, të drejtën dhe detyrimin që në çdo moment të rishohë ecurinë e planit të biznesit, të marrë masa nëpërmjet të gjitha organeve kompetente... Ministria është vetë pjesë e bordit dhe, njëkohësisht, pjesë e një sistemi më të gjerë auditi për mirëmenaxhimin e sitit dhe për ecurinë e këtij plani biznesi.

Plani i biznesit mund të ekuilibrohet në çdo moment.

Qasja dhe dëshira jonë është që brenda dy vjetëve të para të mund të kemi të tjerë donatorë, të tjerë partnerë dhe të tjerë anëtarë në bord, jo vetëm në vendimmarrje, por patjetër edhe anëtarë me fuqi të plotë për shtimin e granteve në fondacion.

Petro Koçi – Faleminderit, zonja Ministre!

Fjalën e ka zoti Ndreca, por dua të them se e vlerësoj shumë çështjen e transparencës rixhide në gjithë këtë proces menaxhimi.

Eduard Ndreca – Faleminderit, zoti Koçi!

Në lidhje me një sqarim të vogël për atë çfarë tha pak më parë kolegja e opozitës, e ndiej detyrim si nënkryetar i Komisionit të Ligjeve...

Në fakt, në Komisionin e Ligjeve nuk ka pasur çështje dakordësie ose jo në lidhje me këtë çështje ose me kalimin në komision të kësaj marrëveshjeje. Thjesht ka qenë çështje e ngarkesës së komisionit dhe e ministres në prezantimin e kësaj marrëveshjeje në komisionet e tjera.

E për shkak se kjo nuk ishte parashikuar në seancën e kaluar plenare dhe në atë që vjen, kemi rënë dakord të shtyhet për një seancë tjetër.

Ndaj, e gjithë sa tha zonja Zhupa është e pavërtetë në lidhje me ecurinë e Komisionit të Ligjeve...

Petro Koçi – Nuk e pengon komisionin tonë.

Eduard Ndreca – ... në raport me këtë marrëveshje.

Sa i përket sjelljes, e përmendi zoti Koçi, padyshim ishte tejet e pahijshme. Në fakt, unë teksa dëgjova edhe prezantimin e ministres, arrij në konkluzionin se as zonja Zhupa, besoj as të tjerët, nuk kanë lexuar qoftë edhe një rresht nga relacioni që na është dhënë për këtë marrëveshje. Sepse besoj që gjithçka ishte shteruese në trajtimin që bëri ministrja dhe relatorja.

Ne e duam Europën, e duam të renë, por këto inovacionet që vijnë nga Europa nuk i qasim, nuk i pranojmë domethënë, ndaj edhe sjellja e këtyre të opozitës më duket absurde.

Edhe unë e kisha si pyetje që në krye të herës: “Cilat kanë qenë praktikat më të mira të cilat ju keni parë?”, por, në fakt, pyetja mori përgjigje.

Në diskutimin që u bë nga ministrja, unë vendosa katër kolona të rëndësishme të kësaj marrëveshjeje: shteti, UNESCO, Fondacioni dhe Instituti i Arkeologjisë. Tani, të tre këta garantë të kësaj marrëveshjeje, shteti, UNESCO dhe Instituti i Arkeologjisë, sipas fjalës së zonjës ministre, kanë qenë dakord dhe kanë dhënë pëlqimin e tyre, bazuar edhe në përvojat europiane në lidhje me këtë çështje. Dhe unë besoj se këtu bien të gjitha diskutimet e tjera apo hamendësimet e tjera se “Po shitet pasuria kombëtare e të tjera e të tjera”.

Për ta sqaruar edhe pak më tej, zonja Ministre, unë do të kisha dëshirë të dëgjoja në mënyrë më të detajuar, për shembull, e zëmë se kjo marrëveshje nuk ka pritshmërinë që ju keni ose nuk do të sjellë pritshmërinë që ju keni, cilat janë masat që ju keni parashikuar? Në fakt, e cekët në fjalën tuaj, por do ta desha në mënyrë pak më të detajuar se cilat janë masat që ju parashikoni, në mënyrë që ne të mos pësojmë dëm financiar ose mosfunksionim të kësaj marrëveshjeje?

Kjo është pyetja që unë kam.

Faleminderit!

Petro Koçi – Faleminderit, zoti Ndreca!

Zonja Ministre, fjala për ju.

Elva Margariti – Faleminderit për saktësimin, në fakt, për sa i përket prezencës në komisione!

Unë kam kërkuar në mënyrë specifike, për shkak të axhendës për mosprezencën time në territorin shqiptar në datën e caktuar nga komisioni, që ajo datë të shtyhej dhe të ishte ministri

prezent në komision, gjë e cila është pranuar nga Komisioni i Ligjeve dhe nga komisionet e tjera. Kjo është e vetmja arsye dhe nuk ka asnjë element shmangieje në asnjë nga komisionet për këtë procedurë.

Për sa i përket të gjithë aspektit ligjor të marrëveshjes, është e vërtetë, është i detajuar i gjithë hartimi, mbarëvajtja e marrëveshjes, shkaqet dhe pasojat, si dhe të gjitha procedurat ligjore që ndiqen nëse ministria vendos që kjo marrëveshje nuk po ecën sipas linjave guidë të planit ose sipas planit të biznesit.

Është një aspekt tërësisht ligjor, ndaj do të doja që ta parashtronte më qartë për të gjithë ju përfaqësuesi i studios ligjore.

Alban Shanaj – Faleminderit!

Zoti Ndreca, faleminderit për pyetjen, e cila, në fakt, është pyetje që na ka shqetësuar gjatë negociimit të marrëveshjes!

Nëse u rikthehem pak disa temave që janë riprekur nga ministrja, nga zonja Tahiraj dhe nga ju, ministria në këtë rast ka një rol të dyfishtë, është një nga themeluesit e fondacionit, është anëtare dhe kryeson bordin e fondacionit, pra ka një shikim nga brenda të ecurisë së fondacionit. Nuk është se do të ketë një sistem lajmërimi, por është në dijeni në mënyrë të përhershme për zhvillimin e ecurisë së fondacionit. Ky është roli i saj i parë.

Roli i dytë. Ministria ka detyrimin ligjor të mbikëqyrë punën e Fondacionit dhe të çdo enti që në Shqipëri kryen aktivitet në trashëgiminë kulturore.

Të dyja këto elemente janë të pasqyruar në marrëveshjen e administrimit dhe ministria ka... Ne kemi parashikuar dy mekanizma mbikëqyrjeje dhe veprimi.

I pari është vlerësimi dhe monitorimi i aktivitetit. Zonja Ministre e tha se një herë në vit fondacioni paraqet një relacion të detajuar mbi ecurinë e veprimtarisë së vitit paraardhës.

Mekanizmi i dytë që kemi parashikuar është ai *step in*, një mekanizëm ndërhyrjeje i ministrisë, kur fondacioni ka dështuar në kryerjen e një apo disa prej detyrave të tij kryesore. Pra, ministria ka një mekanizëm të parashikuar në marrëveshjen e administrimit, që e lejon të ndërhyjë menjëherë dhe në afate të shkurtra për të marrë përsipër atë pjesë apo tërësinë e administrimit të Butrintit, kur Fondacioni ka dështuar në kryerjen e tyre. Pra, të dyja këto mekanizma, vlerësimi dhe monitorimi i vazhdueshëm dhe ndërhyrja specifike *ad hoc* në rastet e urgjencës na bëjnë të mendojmë se kemi parashikuar një mekanizëm, që nuk do të lejojë që Butrinti të dështojë apo të shkojë në keqadministrim.

Petro Koçi – Faleminderit!

Zoti Spaho, e ka fjalën.

Florenc Spaho – Në fakt, na pëlqen të gjithëve që kjo marrëveshje ka të paktën disa aktorë garant, siç janë UNESCO-ja dhe Instituti i Arkeologjisë, po ashtu edhe shteti, për të qenë më të drejtpërdrejtë dhe për t'u dhënë një informacion akoma edhe më të shtuar qytetarëve, të cilët na ndjekin. Patjetër, Parku Kombëtar i Butrintit është një vlerë e shtuar dhe një aset i gjithë Shqipërisë dhe i gjithë shqiptarëve. Për sa i përket fondacionit, i cili ka marrë në administrim edhe do të rijetësojë si parkun kombëtar, por edhe nënzonat përreth, a e ka eksperiencën e duhur dhe a ka marrë objekte të tjera, si parku kombëtar, në administrim? Përveç modelit italian, që ne patjetër jemi pro këtij lloj modeli për ta rijetësuar parkun kombëtar akoma më shumë, por edhe pse jo nënzonat përreth parkut për të investuar, pyetja e drejtpërdrejtë është: çfarë eksperience ka treguar më parë ky fondacion?

Së dyti, mora një përgjigje edhe nga përfaqësuesi i studios ligjore, por për sa i përket pjesës ligjore dhe ekonomike a do të ketë një grup pune që do të ndiqet jo vetëm nga studiot ligjore për të ndjekur pjesën e kontratave, por nga ministra një grup specialistësh që herë pas here do të bëjnë kontrolle, të cilat do të monitorojnë punën dhe angazhimin që ka marrë ky fondacion?

Faleminderit!

Petro Koçi – Faleminderit, zoti Spaho!

Zonja Ministre.

Elva Margariti – Patjetër që po sjellim një model të ri të menaxhimit dhe modele të tilla të integruara fillojnë të hartohen edhe në bazë të një kuadri ligjor të ri. Nuk kemi modele të ngjashme në Shqipëri të këtij lloj integrimi, por kemi linjat guidë të planit të menaxhimit të rakorduar me UNESCO-n, të rakorduar me shumë aktorë në ministri apo institucione të ndryshme në Shqipëri dhe kemi patjetër një plan biznesi, i cili u përshtatet në mënyrë të detajuar linjave guidë dhe rekomandimeve të planit të menaxhimit. Pra, e gjithë qasja është një qasje e integruar dhe vjen për herë të parë në këtë lloj forme. Atë që thashë edhe në fillim, partneri i përgjigjet një plani menaxhimi të hartuar dhe të miratuar më parë, prandaj edhe neve na krijohet qasja pozitive dhe na krijohet synimi dhe objektivi që, duke ecur në linjat e planit dhe duke e përshtatur atë sipas planit të biznesit, të arrijmë në objektivat që kemi parashikuar në plan. Prandaj, patjetër është hera e parë që e shikojmë në një aspekt kaq integral dhe, nga ana tjetër, numrat flasin vetë në letër dhe janë

ato që ne parashtrijmë, prandaj e kalojmë këtë marrëveshje, sepse kemi ata indikatorë, kemi ata objektiva që kërkohen nga ky fondacion.

Për sa i përket pyetjes së dytë, po njëlloj është aspekti tërësisht ligjor dhe do të merrni një përgjigje më të detajuar.

Alban Shanaj – Në fakt, ekziston një grup monitorimi dhe nga momenti që marrëveshja miratohet në parlament brenda 10 ditëve, ngrihet njësi e monitorimit brenda Ministrisë së Kulturës, e cila ka tagrin jo vetëm të shqyrtojë relacionin e paraqitur nga fondacioni, por edhe të kryejë monitorime në sit. Pra, edhe njësi e monitorimit të ministrisë mund të kryejë një vlerësim dhe shqyrtim të ecurisë së veprimtarisë në terren. Pra, e kemi këtë grup monitorimi për t'iu përgjigjur pyetjes suaj.

Elva Margariti – Dua të shtoj diçka që për të gjitha sitet e UNESCO-s Shqipëria plotëson një raport të detajuar që dërgohet çdo vit në të gjitha zyrat qendrore të UNESCO-s. Është ky raporti i të gjithë ecurisë dhe jo vetëm i ruajtjes së konservimit apo restaurimit të këtyre siteve, por edhe i menaxhimit të tyre, është pjesë integrale e të gjithë raportit që kalohet në UNESCO. Pra, monitorimi shkon përtej ministrisë ose të gjitha raportimeve, që do të kthehen për shkak të aspekteve financiare që raportohen në institucione të ndryshme këtu në vend, por shkon deri në raportimin UNESCO-s. Siç e thashë në fillim, mund ta kishim filluar me një model shumë më të thjeshtë, me një sit shumë më të vogël, por e filluam pikërisht në këtë sit, sepse duam të kemi aktorë të shumtë, sy të shumtë që e shikojnë modelin dhe në momentin që ky model do të vendoset në shinat, në mekanizmat optimalë të funksionimit, do të kthehet në një model të replikueshëm edhe në sitet e tjera. Për unicitetin që ka siti, patjetër që kemi një objektiv madhor që ta kthejmë në të parin park kombëtar *carbon free*. Ky është për ne pastaj tejkalimi për ta çuar Butrintin përtej Shqipërisë, përtej UNESCO-s po themi, por si një element një brend të fortë në rajon.

Petro Koçi – Faleminderit, zonja Ministre!

I fundit zoti Beqiraj e ka fjalën.

Ismet Beqiraj – Faleminderit!

Unë, në radhë të parë, do ta quaj një risi, në zbatim të ligjit nr. 27/2018, që është një ligj për trashëgiminë kulturore e muzetë dhe i kalon përmasat e një ligji, por është një kod. Kjo është një marrëveshje e parë për të jetësuar parqet arkeologjike, për t'i kthyer në vlerë ekonomike, jo vetëm kulturore, që ka shumë rëndësi të prodhojnë ekonomi, punësim, zhvillim të infrastrukturës rurale. Pyetjet që unë kisha menduar për t'i bërë dolën nga pyetjet që bënë kolegët parafolës dhe

nga përgjigjet që u dhanë, jam tejet i qartë, por vetëm një gjë do të sqaroja. Përderisa dy vendimet përkatëse të qeverisë dhe urdhrat kanë kohë që trupëzojnë në finale të gjithë arkitekturën e kësaj marrëveshjeje, nuk e kuptoj se ku është konfidenca dhe fshehtësia e kësaj marrëveshjeje që po miratohet? Ndaj, për risitë që sjell gjithë kjo marrëveshjeje, që ne sot po diskutojmë, ne i hapim një rrugë zhvillimit të një qasjeje të tillë, pra që një zhvillim i tillë të bëhet edhe në zona të tjera. Uroj që edhe në Parkun Arkeologjik të Bylisit të ketë një marrëveshjeje të tillë me fondacione, që nuk kanë qëllim fitimin, por kanë qëllim zhvillimin e asaj zone në të gjitha përmasat.

Faleminderit!

Petro Koçi – Faleminderit, zoti Beqiraj!

Zonja Ministre, shkurt, ju lutem.

Elva Margariti – Thjesht për të sqaruar rastin, është e vërtetë që edhe në Bylis po punohet paralelisht për planin e menaxhimit të integruar. Pra, është plani i menaxhimit ai që na shtron linjat guidë dhe na shtron objektivat dhe mënyrat e administrimit, sipas ligjit të trashëgimisë, që do të jenë më fitimprurëse për sitin. Gjithmonë sitet e trashëgimisë asnjëherë nuk flasim për subjekte, të cilat nuk kanë qëllim fitimin, por kanë qëllim mbarëvajtjen dhe çdo e ardhur mbetet në të njëjtin sit. Në rastin e Bylisit jemi ende në hartimin e këtij plani menaxhimi. Ajo është faza e parë, hapi i parë ligjor që më pas do të çojë në hapa të tjerë operacionalë. Ndërsa me Butrintin kemi ecur më përpara në kohë dhe tashmë plani i menaxhimit është i miratuar prej kohësh dhe, siç thatë edhe ju, marrëveshja e bashkëpunimit dhe marrëveshja e administrimit pas firmosjes, nënshkrimit midis palëve, ka kaluar të gjitha rishikimet ndërmjet institucioneve të ndryshme dhe ka ardhur në parlament e rishikuar sipas objektivave dhe rekomandimeve të institucioneve. Marrëveshja nuk është konfidenciale, marrëveshja është e gjitha e detajuar; elemente të planit të biznesit kanë element konfidencialitetin.

Petro Koçi – Faleminderit, zonja Ministre!

Përpara votimit, relatorja, zonja Tahiraj, ka fjalën.

Dasantila Tahiraj – Në fakt, e vlerësoj të gjithë punën e bërë nga ministria në këtë kohë për jetësimin dhe rritjen e vlerave dhe ndërkombëtarizimin Parkut Kombëtar të Butrintit. Pyetja ime është: si po vepron me jetësimin e kalave nëpër qytetet e Shqipërinë? Gjithashtu, dua të bëj një pyetje konkrete: në cilët hapa jemi me jetësimin e kalasë së qytetit të Elbasanit, e cila është një aset, që, në fakt, duhet të jetësuar dhe duhet zhvilluar për t'i dhënë zhvillim qytetit?

Faleminderit!

Petro Koçi – Sa më shkurt, meqenëse është jashtë rendit të ditës.

Elva Margariti – Kemi shpërndarë forcat dhe mbështetjen për hartimin e planeve të menaxhimit. Në rastin konkret, me BERZH-in kemi një tjetër program mbështetës për hartimin e planit të menaxhimit të disa kalave, në Berat dhe në Gjirokastrë, jemi po njëjloj me site të UNESCO-s dhe këtu me ambicie të madhe. Ndërkohë, për Elbasanin vetë Ministria e Kulturës ka hartuar dy vendime të Këshillit të Ministrave për shpalljen qendër historike dhe zonë arkeologjike për t'i hapur mundësi thithjes së fondeve të dedikuara që qeveria ka vendosur në dispozicion dhe në formë granti për banorët e qyteteve historike.

Petro Koçi – Faleminderit, zonja Ministre!

Faleminderit, të nderuar kolegë, për të gjitha diskutimet serioze dhe trajtimin e duhur të gjitha aspekteve që ka kjo marrëveshje!

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzoneve të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”.

Kush është pro? 11 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është pro? 11 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2 “Hyrja në fuqi e ligjit”. Kush është pro? 11 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Kush është pro? 11 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Më duhet t'ju njoftoj se pas një letre që komunitetet fetare na kanë bërë lidhur me çështjen e radiove dhe medieve për kulturë fetare, ne i kemi dërguar një letër AMA-s, e cila na ka sjellë një sqarim, sipas të cilit, kjo kërkesë për momentin nuk gjen mbështetje ligjore. Pra, AMA vetë e ka të pamundur që t'i licencojë në këtë përmasë që e kërkojnë ata. Kështu që do të thotë që, nëse do të jetë e mundur, ne mund ta shikojmë në vijim që të bëjmë ndryshime në kuadrin ligjon që më pas AMA ta zbatojë.

Për raportin e AMA-s na duhet një relator. Zoti Beqiraj, si me përvojë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord! Atëherë, po ia kaloj zonjës Buxheli.

Zonja Ministre, shumë faleminderit!

Elva Margariti – Faleminderit juve!

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA